



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Agjencia e Kosovës për Akreditim**  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017 Ref.: 540/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2022:
  - Juridik, LLB, 240 ECTS, maksimumi 900 studentë për vit akademik;
  - Kontrata dhe e Drejta Komerciale, LLM, 60 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik;
  - E Drejta Penale, LLM, 60 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik;
  - E Drejta Kushtetuese Administrative, LLM, 60 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik;
  - E Drejta Financiare, LLM, 60 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik;
  - E Drejta Civile dhe Pronësore, LLM, 60 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik;
  - E Drejta Ndërkombëtare, LLM, 60 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik;
  - E Drejta Ndërkombëtare, PhD, 180 ECTS, maksimumi 10 studentë për vit akademik;
  - E Drejta Kushtetuese dhe Administrative, PhD, 180 ECTS, maksimumi 10 studentë për vit akademik.
- II. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Juridik që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Juridik që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Juridik, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit: Juridik, LLB, 240 ECTS, Kontrata dhe e Drejta Komerciale, LLM, 60 ECTS, E Drejta Penale, LLM, 60 ECTS, E Drejta Kushtetuese Administrative, LLM, 60 ECTS, E Drejta Financiare, LLM, 60 ECTS, E Drejta Civile dhe Pronësore, LLM, 60 ECTS, E Drejta Ndërkombëtare, LLM, 60 ECTS, E Drejta Ndërkombëtare, Dr.sc. 180 ECTS, dhe E Drejta Kushtetuese dhe Administrative, Dr.sc. 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Juridik	LLB	240	Beqir Sadikaj, Remzije Istrefi Peci, dhe Visar Morina
2	Kontrata dhe e Drejta Komerciale	LLM	60	Rrustem Qehaja, Valbon Mulaj, dhe Vjosa Osmani
3	E Drejta Penale	LLM	60	Haki Demolli, Azem Hajdari, dhe Rexhep Gashi
4	E Drejta Kushtetuese Administrative	LLM	60	Hava Bujupaj-Ismajli, Murat Jashari, dhe Gjyljeta Mushkolaj
5	E Drejta Financiare	LLM	60	Bedri Peci, Mejdi Bektashi, dhe Bedri Bahtiri
6	E Drejta Civile dhe Pronësore	LLM	60	Haxhi Gashi, Nerxhivane Dauti, dhe Iset Morina
7	E Drejta Ndërkombëtare	LLM	60	Qerim Qerimi, Besfort Rrecaj, dhe Flamur Mrasori
8	E Drejta Ndërkombëtare	Dr.sc.	180	Iliriana Islami, Hajredin Kuci, dhe Enver Hasani
9	E Drejta Kushtetuese dhe Administrative	Dr.sc.	180	Mirlinda Batalli Zhubi, Fisnik Korenica, dhe Arsim Bajrami

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetin Juridik më 17.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura më sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Salvador Rus Rufino, Johannes Falterbaum, Alfonso Martínez-Echevarría, dhe Péter Várnagy.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetit Juridik, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit Juridik;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë